



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: 20.6.2024

Nr: 62

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMITETIT PËRFAQËSUES TË NISMËS
LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE, PËR REGJISTRIMIN E NISMËS LIGJVËNËSE TË
ZGJEDHËSVE “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË
29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 19, pika 2 dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 14, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”,

VËREJ:

Organizata “Shqipëria Bëhet”, me komitet përfaqësues të përbërë nga: Adratik Lapaj, Edlira Cepani, Florian Binaj, Renaldo Salianji, Ergys Llanaj kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 485 Prot., datë 20.02.2024, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 28, datë 6.3.2024, vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Vendimi përcaktoi afatin 3 (tre) mujor nga hyrja në fuqi e tij, për mbledhjen e nënshkrimeve.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa me nr. 1508 prot., datë 6.6.2024, me lëndë “Depozitimi i nënshkrimeve për nismën ligjvënëse, për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar edhe vendimi për autorizimin e grupeve të mbledhjes së nënshkrimeve dhe kopje e projektligjit.

Referuar nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, me depozitimin e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedure të parashikuara në Kodin Zgjedhor për verifikimin e

Data: 20.6.2024 Nr: 62
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i tyre, dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:

- a) regjistron nismën ligjvënese të zgjedhësve;
- b) cakton një afat kohor për plotësimin ose korigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve;
- c) refuzon regjistrimin e nismës nëse nga verifikimi rezulton se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën, duke depozituar identitetin dhe firmat e tyre, është më i vogël se 20 000 zgjedhës.

Në mbështetje të sa më sipër, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e 5 (pesë) përqind të numrit të nënshkrimeve si dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, brenda afatit ligjor të parashikuar.

Në total janë depozituar 33 (tridhjetë e tre) dosje, me 21 000 (njëzet e një mijë) nënshkrime. Në referim të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënese të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet që nisma ligjvënese të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës. Ka rezultuar se numri i zgjedhësve të cilët kanë mbështetur nismën e plotëson numrin prej 20 000 zgjedhësish të kërkuar nga ligji.

Përsa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nënshkrimet e depozituara nga përfaqësuesit e nismës ligjvënese për të propozuar projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe si të tilla duhet të pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 2 dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 14, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënese të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S:

1. Regjistrimin e nismës ligjvënese të zgjedhësve “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI